REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE

MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJ

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT
## PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI NË KOMUNËN E FUSHË KOSOVËS 2026-2029

**Maj 2026**

**Njoftim për qytetarët e Komunës së Fushë Kosovës**

Komuna e Fushë Kosovës ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali për periudhën 2025-2027. Ky plan shpreh vullnetin dhe përgjegjësinë institucionale për përmirësimin e mirëqenies, dhe avancimin e përfshirjes aktive të këtyre komuniteteve në zhvillimin e komunës.

Sipas regjistrimit të fundit të vitit 2024, komunitetet Rom dhe Ashkali përbëjnë rreth 7.5% të popullsisë së Komunës së Fushë Kosovës. Këto komunitete kanë përfaqësim politik në Kuvendin Komunal, ku në legjislaturën 2025-2029 z. Suhat Ademi nga komuniteti Egjiptian mban pozicionin e anëtarit të Kuvendit të Komunës, përfaqësuesi i komunitetit ashkali, z. Gëzim Gara mban pozicionin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, z. Dashnim Bajrami mban pozicionin e Kryesuesit te Komitetit për Komunitete dhe pozitën e Drejtorit të Drejtorisë se Inovacionit, Teknologjisë Informative dhe Integrimeve Evropiane e mbanë z. Resul Makreshi.

Në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile, të cilat zbatojnë projekte të ndryshme të financuara nga Komuna dhe realizmin e shumë projekteve nga ekzekutivi i komunës për këto komunitete, Komuna ka zbatuar Planin Komunal të Veprimit për periudhën 2018–2021, duke demonstruar angazhim institucional dhe politik për përmirësimin e kushteve të komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe për të vazhduar këtë kontinuitet të avancimit të komuniteteve ka përgatitur planin e ri përmes këtij Plani Lokal të Veprimit 2025-2027, Komuna e Fushë Kosovës synon të përmbushë standardet e të drejtave të njeriut, siç përcaktohen në konventat ndërkombëtare, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.

Vizioni i Komunës është:

**“Komuna e Fushë Kosovës do të jetë një ambient ku të gjitha komunitetet gëzojnë të drejta të barabarta në të gjitha fushat jetësore dhe bashkëjetojnë me respekt të ndërsjellë dhe harmoni me qytetarët e tjerë.”**

Misioni ynë është:

**“Të kontribuojmë në avancimin e përfshirjes së komuniteteve Rom dhe Ashkali duke mbështetur aktivitete për sigurimin e arsimit cilësor, rritjen e punësimit, përmirësimin e mirëqenies sociale, ofrimin e shërbimeve shëndetësore, kushtet për strehim dhe banim të qëndrueshëm, dhe zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit.”**

Ky Plan është përgjegjësi institucionale dhe një thirrje për bashkëpunim të gjithmbarshëm nga të gjithë qytetarët!

Ky dokument është përgatitur nga Komiteti Komunal Veprues , përfaqësuesve tjerë nga drejtorit e ndryshme te komunës dhe përfaqësuesit të OJQ-eve.

PËRMBAJTJA..........................................................................................Error! Bookmark not defined...........3

SHKURTESAT ..........................................................................................4

1. HYRJE ..........................................................................................5

1.1. Metodologjia..........................................................................................5

2. ANALIZA E GJENDJES..........................................................................................7

2.1. Arsimi..........................................................................................7

2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale ..........................................................................................11

2.3. Shëndetësia..........................................................................................13

2.4. Banimi..........................................................................................16

2.5. Diskriminimi..........................................................................................12

3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET ..........................................................................................19

3.1. Arsimi..........................................................................................19

3.1.1. Rezultatet e pritshme..........................................................................................203

3.1.2. Përshkrimi i aktiviteteve ..........................................................................................204

3.1.3. Supozimet dhe rreziqet..........................................................................................16

3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale ..........................................................................................17

3.2.1. Rezultatet e pritshme..........................................................................................257

3.2.2. Përshkrimi i aktiviteteve ..........................................................................................18

3.2.3. Supozimet dhe rreziqet..........................................................................................20

3.3. Shëndetësia..........................................................................................21

3.3.1. Rezultatet e pritshme..........................................................................................30

3.3.2. Përshkrimi i aktiviteteve ..........................................................................................21

3.3.3. Supozimet dhe rreziqet..........................................................................................33

3.4. Banimi..........................................................................................333

3.4.1. Rezultatet e pritshme..........................................................................................34

3.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve ..........................................................................................34

3.4.3. Supozimet dhe rreziqet..........................................................................................354

3.5. Diskriminimi..........................................................................................25

3.4.1. Rezultatet e pritshme..........................................................................................25

3.4.2. Përshkrimi i aktiviteteve ..........................................................................................345

3.4.3. Supozimet dhe rreziqet..........................................................................................356

4. BUXHETI ....................................................................Error! Bookmark not defined.

5. PLANI I ZBATIMIT .................................................................................................. 38

## SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| **ASK** | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| **DKA** | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| **DSHMS** | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| **IP** | Institucionet Parashkollore |
| **MAShT** | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë |
| **MSh** | Ministria e Shëndetësisë |
| **OJQ** | Organizata Joqeveritare |
| **OSHC** | Organizatat e Shoqërisë Civile |
| **PLV** | Plani Lokal i Veprimit |
| **PRTAN** | Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes |
| **QKMF** | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare |
| **QKUK** | Qendra Klinike Universitare e Kosovës |
| **QM** | Qendra Mësimore |
| **QMF** | Qendra e Mjekësisë Familjare |
| **QPS** | Qendra për Punë Sociale |
| **QAP** | Qendra e Aftësimit Profesional |
| **IKAP** | Institucioni i Kosovës për Administratë Publike |
| **SISH** | Sistemi i informimit shëndetësor |
| **SMIA** | Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim |
| **SWOT** | Sukseset, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet |
| **ZP** | Zyra e Punësimit |
| **ZKKK** | Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim |
| **ZQM** | Zyra për Qeverisje të Mirë |
| **ZK** | Zyra e Kryeministrit |
| **KKV** | Komiteti Komunal Veprues |
| **TDH** | Terre Des Home |

# 1. HYRJE

Për të avancuar gjendjen aktuale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM) në Zyrën e Kryeministrit ndërmori iniciativën për hartimin e strategjisë së re për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom , ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës. Pas një procesi të gjatë, gjithëpërfshirës dhe konsultimesh me të gjithë arteret, në korrik të vitit 2022 u aprovua Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026.

Kjo strategji, si dokument i nivelit nacional, parashikon një seri aktivitetesh që do të zbatohen në nivel komunal, sidomos nga komunat që kanë një popullsi më të madhe të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Zbatimi i objektivave strategjike të Strategjisë së Republikës së Kosovës në nivel komunal përmban në vete formimin e Komitetit Komunal Veprues, hartimin e Planit Lokal të Veprimit, monitorimin e zbatimit dhe raportimin adekuat për realizimin e këtyre obligimeve në nivel komunal, ku parashihet edhe koordinimi vertikal midis Qeverisë dhe institucioneve komunale.

Sipas statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga regjistrimi i fundit i zhvilluar nga data 05.04 deri më 24.05.2024, Komuna e Fushë Kosovës ka arritur sipas të dhënave numrin e popullsisë prej 63,949 banorë, që do të thotë është dyfishuar numri i banorëve nga regjistrimi i fundit në vitin 2011. Nga gjithsej 38 komuna të Kosovës, 9 prej tyre kanë pasur rritje të numrit të popullsisë, ku në mesin e tyre është edhe Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa 29 komuna të tjera kanë pësuar zvogëlim të popullsisë.

Në Komunën e Fushë Kosovës, sipas regjistrimit të vitit 2024, numri i popullsisë nga komunitetet që jetojnë në këtë komunë është: 3,224 ashkalinj (5.04%), 498 romë (0.78%) dhe 850 egjiptianë (1.33%). Pra, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë, në Komunën e Fushë Kosovës jetojnë gjithsej 4,572 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian.

Pjesa më e madhe e komuniteteve rom dhe ashkalinj në Komunën e Fushë Kosovës jetojnë në pjesën urbane të qytetit, të përqendruar kryesisht në lagjet 028, 029, 02, 07 dhe në fshatin Kuzmin.

Për të adresuar problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Komuna e Fushë Kosovës ka iniciuar procedurën e hartimit të Planit Lokal të Veprimit për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali të Komunës së Fushë Kosovës 2026-2028. Për hartimin e këtij dokumenti strategjik, Kryetari i Komunës, me Vendim me Nr.1395 të datës 11.08.2025, ka formuar Komitetin Komunal Veprues, bazuar në Strategjinë e Republikës së Kosovës, ky Vendim pas formimit te qeverisjes se re është ndryshuar në përbërje si në vijim:

1. Gëzim Gara - Nënkryetari i Komunës për Komunitete – Kryesues i KKV-së;
2. Sladjana Lazic - Shefe e Zyrës për Komunitete – Koordinatore e KKV-së;
3. Albana Gashi - Drejtore e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – anëtare;
4. Hysen Sllamniku – Shefe e Sektorit për Mirëqenie Sociale –anëtare;
5. Lindita Dervisholli - Koordinatore e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore – anëtare;
6. Mobere Pllana- Zyrtare e Lartë për Ndërtim – anëtare;
7. Nurija Fazliu - Zyrtare e Lartë për Integrime Evropiane – anëtare;
8. Elmije Grajçevci – Shefe e Arsimit – anëtare;
9. Abaz Xhigoli - Drejtor i Qendrës për Punë Sociale – anëtar;
10. Gëzime Krasniqi - Zyrtare në Zyrën për Punësim – anëtare;
11. Faton Kelmendi - Përfaqësues i Organizatës IOM – anëtar;
12. Qefsere Simnica – Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – anëtar;
13. Resul Makreshi –Drejtor i Drejtorisë për Teknologji informative, Invoacion dhe Integrime Evropiane – anëtar;
14. Ridvan Gashi - Përfaqësues i OJQ-së 'Multiethnic Culture of Kosova' – anëtar;
15. Rrahman Stollaku - Përfaqësues i OJQ-së 'Ballkan Sunflowers' – anëtar;
16. Bardhyl Kojçiçi- Drejtor i Drejtorisë për Busxhet dhe Financa – anëtare.

Me formimin e Komitetit Komunal Veprues, Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës ka caktuar Koordinatoren e KKV-së, e cila në rastin tonë është Shefja e Zyrës së Komuniteteve znj. Sladjana Lazic, e cila ka koordinuar proceset e trajnimit, takimeve konsultative, punëtorive dhe së bashku me anëtarët e komitetit ka planifikuar metodologjinë e hartimit të këtij plani, zbatimin, monitorimin dhe raportimin.

## 1.1. Metodologjia

Pas themelimit të Komitetit Komunal Veprues, për anëtarët e këtij Komiteti është organizuar një trajnim profesional nga ana e OSBE-së. Më pas, janë zhvilluar katër takime konsultative të KKV-së dhe një punëtori për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës për periudhën 2026-2028.

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit 2026-2028 të Komunës së Fushë Kosovës, duke u bazuar në Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026 në nivel nacional, është përqendruar në pesë fusha kryesore:

1. Arsimi
2. Punësimi dhe Mirëqenia Sociale
3. Shëndetësia
4. Banimi
5. Diskriminimi

Për këto fusha, nga ana e anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues të Komunës së Fushë Kosovës — ku përveç përfaqësuesve nga ekzekutivi i komunës, marrin pjesë edhe organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që njihen me problemet e këtyre komuniteteve në

nivel komunal, si dhe përfaqësues të institucioneve tjera qeveritare — janë grumbulluar të dhëna zyrtare sipas fushave të cekura më lartë. Bazuar në këto të dhëna, është përgatitur për secilën fushë një analizë SWOT dhe është pasqyruar gjendja aktuale e komuniteteve në komunën tonë. Në bazë të kësaj analize janë përcaktuar objektivat, aktivitetet dhe në fund edhe buxheti për realizimin e tyre.

# 2. ANALIZA E GJENDJES

Punëtoria e parë për hartimin e Planit të Veprimit ka pasur për qëllim analizën e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës  në këto 5 fusha: Arsimi; Punësimi dhe Mirëqenia Sociale;  Shëndetësia, Banimi dhe Diskriminimi.
Gjithsej numër i shkollave në nivel para universitar në Komunën e Fushë Kosovës janë 13 nga të cilat : 9 janë fillore të mesme të ultë ( një prej tyre është duke punuar me sistemin arsimor serbe, tri janë shkolla të mesme të larta , një institucion parashkollor dhe një institucion parashkollor publiko-privat. Në vitin shkollor 2024/2025 janë hapur edhe 10 paralele të reja për parashkollor në qytetin e Fushë Kosovës, mirëpo vetëm në shkollat ku kemi pasur hapësirë në objekte, ndërsa në vitin shkollorë 2025/2026 pritet të hapën edhe paralele të tjera ku i mundësohet fëmijëve të komuniteteve përfshirja.
Sipas statistikave të Drejtorisë së Arsimit, numri i  nxënësve të përfshirë në Arsimin fillor në vitin shkollor 2024/2025 është 10,559.00 nxënës që vijojnë mësimin në Gjuhën shqipe,  88 nxënës që vijojnë mësimin në gjuhën serbe prej tyre në shkollën fillore të mesme të ulët janë 607 nxënës të komunitetit Ashkali , 5 të komunitetit Rom , 29 të komunitetin Egjiptian , 4 të komunitetit Turk dhe 4 të komunitetit Goran, ndërsa në shkollën e mesme të lartë kemi 41 nxënës të komunitetit Ashkali.

## 2.1. Arsimi

Bazuar në statistikat e DKA-së në Fushë-Kosovë, sikur në gjithë Kosovën, përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit para universitar, edhe pse me kushte dhe objekte të njëjta, mbetet në nivel jo të kënaqshëm për sa i përket suksesit , krahasuar me fëmijët që vijnë nga komunitetet e tjera.
Drejtoria Komunale për Arsim të Komunës së Fushë Kosovës me prioritet ka ngritjen e cilësisë në mësim, mbrojtjen dhe zbatimin e ligjshmërisë në punë, zbatimin e reformave arsimore të dala nga Ligji për Arsimin në Komunat e Kosovës, zbatimin e Kurrikulës së re të Arsimit, pastaj rritjen e disiplinës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies, krijimin e kushteve të mira teknike në punë për të gjithë stafin Arsimor, ngritjen e kapaciteteve të stafit Arsimor përmes trajnimeve

nga MASHT-I dhe DKA-ja, veçanërisht për Arsimtarët e rinjë dhe ata Mësimdhënës të profileve profesionale.

***Me fokus në planin dinamik të DKA mbetet instrumenti i kontrollit dhe mbikëqyrjes profesionale në të gjitha institucionet edukativo-arsimore për punë dhe rezultate më të mira në sistemin e arsimit lokal.***

Sipas statistikave të marra në secilën shkollë, në Arsimin e detyruar, përkatësisht në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1 – 9), në Komunën e Fushë –Kosovës nga numër I përgjithshëm i nxënësve braktisje kemi 30 nxënës në vitin shkollor 2024/2025 (me mundësi kthimit në shkollë).

Në tabelën e mëposhtme janë elaboruar informatat e vijueshmërisë për secilën shkollë sipas përkatësisë etnike dhe sistemit edukativ në të cilin fëmijët vijojnë mësimin.
Sistemi paralel na pamundëson qasjen e të dhënave zyrtare në një pjesë të objektit në Shkollën ‘Daut Bogujevci’ ku mësojnë fëmijët në Gjuhën Serbe.

| **Shkolla** | **Rom** | **Ashkalinj** | **Egjiptian** |
|---|---|---|---|
| SH.F. ‘Selman Riza’ | 4 | 351 | 17 |
| SH.F. ‘Mihal Grameno’ | | 30 | |
| SH.F. ‘Daut Bogujevci’ | | 187 | 1 |
| SH.F. ‘Bajram Curri’ (Henc) | | 3 | |
| SHML “Minatori” | | 14 | 1 |
| SHML ‘Hoxh Kadri Prishtina” | | 20 | 4 |
| Gjimnazi “Hivzi Sylejmani” | | 6 | |
| **Gjithsej** | **4** | **611** | **23** |

**Sipas statistikave të Zyrës së Komuniteteve të Komunës së Fushë Kosovës në shkollat të cilat vijohet mësimi në gjuhën serbe janë si në vijim:**

| **Shkolla** | **Rom** | **Ashkali** | **Egjiptian** |
|---|---|---|---|
| PNF ‘Aca Marovic’ Fushë-Kosovë | 40 | | |
| SH.F. ‘Aca Marovic’ Kuzmin | 44 | | |
| **Gjithsej** | **84** | | |

Në shkollat e mesme në Fushë-Kosovë vijojnë mësimin për vitin shkollor 2024/2025, 1277 nxënës ku prej tyre 45 nxënës janë të komunitetit Ashkali dhe Egjiptian , ku në shkollat profesionale janë 39 nxënës, ndërsa në gjimnaz janë 6 nxënës.

Për shkak të Migrimit dhe Emigrimit të qytetarëve Komuna e Fushë-Kosovës nuk ka të dhëna zyrtare të sakta se sa është numri i fëmijëve/nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që nuk janë të përfshirë në secilin nga nivelet e sipërpërmendura të edukimit/arsimit para universitar, prandaj dhe është e pamundur që të konstatohet me saktësi për nivelin e përfshirjes.

Gjendja jo e mirë socio-ekonomike me të cilën ballafaqohen këto tri komunitete (veshmbathja e dobët e fëmijëve, mungesa e mjeteve dhe materialeve të ndryshme shkollore), vetëdijësimi i

ulët i prindërve për rëndësinë e edukimit, janë po ashtu faktorë të braktisjes së shkollës nga komunitetet.

Përveç nivelit jo të kënaqshëm të braktisjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit para universitar, shqetësim tjetër konsiderohet edhe suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë, megjithëse për këtë nuk ka statistika të sakta zyrtare. Analiza SWOT e zhvilluar gjatë punëtorisë nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në gjendjen aktuale të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës.

**Tabela e Analizës SWOT në fushën e Arsimit**

| Sukseset | Mundësitë |
|---|---|
| • Vizitë të herë pas hershme për të monitoruar vijimit e procesit mësimor nga ana e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian<br>• Motivimi i nxënësve të komuniteteve për vazhdimin e shkollimit, përmes aktiviteteve të përbashkëta (Dita e Shkollës, Festa e 17 Shkurtit , Festa e Abetares etj.)<br>• Ofrimi i subvencioneve për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian<br>• Përfshirja e komuniteteve në mësimin e rregullt<br>• Zvogëlimi i rasteve të braktisjes<br>• Ofrimi i librave dhe mjeteve shkollore falas për nxënësit<br>• Ofrimi i mundësive të barabarta në nivel komunal për të gjithë (gjithë përfshirja) | • Bashkëpunim i shtuar në mes Ekipeve për mos-braktisje të shkollës<br>• Zbatimi i projekteve të ndryshme nga donatorët dhe OJQ-të<br>• Kornizë ligjore e kompletuar në nivel komunal<br>• Ndarja e subvencioneve për studentë nga radhët e komuniteteve<br>• Lirimi i nxënësve nga pagesa për edukimin jo-formal<br>• Organizimi i fushatave vetëdijësuese<br>• Financimi për shënimin e festave të komuniteteve nga ana e Komunës<br>• Ofrimi i mundësive të shprehjes së talentit përmes artit |

| | |
|---|---|
| • Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar në shkollë<br>• Përfshirja e fëmijëve të integruarve të huaj në shkollë<br>• Lirimi nga pagesa për mësimin jo formal për fëmijët e komunitetit që janë të përfshirë në skemën sociale<br>• Punësimi i kuadrit mësimor nga komunitetet<br>• Në vitin shkollor 2024/2025 hapja e paraleleve për parashkollorë | |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |
| • Mungesa e kudretit të kualifikuar nga komunitetet për mësimdhënës<br>• Mungesa e fushatave informuese për mundësitë e vazhdimit të shkollimit<br>• Mungesa e vazhdimit të kurseve të veçanta për shkrim-lexim<br>• Martesat e hershme<br>• Vetëdijësimi i ulët i prindërve të komuniteteve për rëndësinë e shkollimit<br>• Mos-vazhdimi i shkollimit të mesëm të lartë<br>• Mos-regjistrimi në institucione parashkollore<br>• Mungesë e ndëshkimit për mos-zbatim të dispozitave ligjore<br>• | • Martesat e hershme<br>• Ndërprerja e studimeve nga studentët për shkak të kushteve ekonomike<br>• Migrimi i të rinjve<br>• Varfëria<br>• Braktisja e shkollimit<br>• Rezultatet e dobëta në mësim<br>• Analfabetizëm funksional<br>• Emigrimi i shpeshtë i komuniteteve |

| | |
|---|---|

## 2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare shkalla e papunësisë në komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë është alarmante. Papunësia në këto grupe komunitare arrin mbi 90%, me disa vlerësime që shkojnë deri në 95% ose më shumë sipas të dhënave jo zyrtare të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore. Agjencioni i Statistikave të Kosovës do të del me statistika analitike sa i përket punësimit të këtyre komuniteteve, për secilën komunë në nëntor të vitit 2025.

Statistikat nga ZKKK tregojnë se gjatë vitit 2025, të punësuar në institucione publike janë 3 dhe me projektet aktuale janë 18 ashkali. Megjithatë, ekziston një diferencë e lartë në mes të numrit të punësuarve nga komunitetet dhe punëkërkuesve.

Përveç shkaktarëve të përgjithshëm që ndikojnë në nivelin e lartë të papunësisë, ka edhe shkaktarë të veçantë që i kontribuojnë papunësisë së madhe të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë – Kosovës. Njëri nga këta shkaktar është mungesa e kuadrove me kualifikime universitare nga radhët e këtyre komuniteteve, gjë që pamundëson ose vështirëson punësimin e tyre në mungesë të plotësimit të kritereve ligjore, posaçërisht në sektorin publik, sidomos deri në arritjen e plotësimit të kuotave për punësimin e komuniteteve që parashihen me ligj.

Shkaktari tjetër është mungesa e të dhënave për të punësuarve në sektorin privat.

Niveli i lartë i papunësisë së pjesëtarëve të komuniteteve ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në mirëqenien sociale të tyre. Numri i familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që janë përfitues të asistencës sociale është 410 apo 50% e përfituesve total të skemës sociale në Komunën tonë dhe një numër i caktuar i familjeve me gjendje jo të mirë ekonomike.

Analiza SWOT e zhvilluar gjatë punëtorisë nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë- Kosovës.

**Tabela e Analizës SWOT në fushën e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale**

| Sukseset | Mundësitë |
|---|---|
| • Vetëdijësimi për shërbimet komunale<br>• Ofrimi i pakove të ndihmave nga Komuna për familjet në nevojë (ushqim, higjienë)<br>• Ofrimi falas i përfaqësimit – ndihëm juridike flasë<br>• Informimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për masat aktive të tregut të punës<br>• Asistimi në përzgjedhjen e profesionit / zanatit në QAP<br>• Ofrimi i asistencës për hartimin e planeve të biznesit të vetëpunësimit<br>• Furnizimi me mjete shkollore<br>• Fushata për regjistrim civil për raste të regjistrimit me vonesë | • Bashkëpunim të vazhdueshëm me Zyrën e Punësimit dhe QAP<br>• Organizimi i konferencës së donatorëve dhe tërheqja e donacioneve<br>• Përgatitja e kuadrove për punësim<br>• Ndjekja e kurseve QAP<br>• Përfshirja në punë praktike në institucione publike dhe projektet e ndryshme të punësimit<br>• **Përkrahja e ekonomive familjare sidomos familjeve jashtë skemave sociale pa të hyra te rregullta mujore**<br>• **Avokim për ngritjen e vetëdijes për vazhdimin e shkollimit të mesëm dhe universitar**<br>• Fushata vetëdijësuese për planifikimin familjar<br>• Vazhdimi i bashkëpunimit me OJQ-ët vendore dhe ndërkombëtare të cilat ofertojnë shërbime sociale në përmbushje të nevojave të familjeve |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |
| • Mos përfshirja e të gjithë të interesuarëve për ofrimin e trajnimeve nga QAP në kohë dhe përzgjedhja e tyre<br>• Ngritja e koordinimit të Zyrës së Punësimit me organet tjera komunale | • Numër i vogël i të punësuarve në institucionet publike<br>• Migrimi për shkak të një jete më të mirë |

| | |
|---|---|
| • Mundësi të kufizuara për punësim në sektorin publik<br>• Mungesa e kuadrove profesionale sipas kërkesave të tregut të punës<br>• Kufizimet e buxhetit për shërbimet sociale<br>• Mungesa e të dhënave për të punësuarit në mesë të sektorit privat , komunës dhe zyrës të punësimit | • Mungesa e fondeve për ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme në QAP<br>• Mos-planifikimi familjar<br>• Shtimi i numrit të rasteve sociale<br>• Varësia nga ndihmat<br>• Familjet në gjendje ekonomikisht të pa favorshme kanë mundësi reale të përfshihen në probleme familjare si për shembull: zgjidhje të martesave , viktima të dhunës në familje , fëmijët e dalë jashtë kontrollit prindëror, përdorues të substancave , fëmijët në kërkim lëmoshë , braktisje të shkollës etj. |

## 2.3. Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore në Komunën e Fushë Kosovës,  kanë një shtrirje të gjerë dhe mbulojnë mjaft mirë të gjithë territorin e Komunës. Drejtoria e Shëndetësisë  dhe Mirëqenies Sociale ka  bërë përmirësimin e infrastrukturës së objekteve shëndetësore (QKMF,QMF dhe AMF) si dhe pajisjeve mjekësore me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe ofron shërbime shëndetësore 24h për të gjithë qytetarët e saj. Megjithatë, ende ka nevojë për ngritjen e  vetëdijes për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, pra  nga  ana e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian e veçanërisht  për sa i përket sëmundjeve të ndryshme ngjitëse dhe kronike , vaksinimit  të fëmijëve dhe planifikimit familjar.
Analiza SWOT e zhvilluar gjatë punëtorisë nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në shëndetin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës.

**Tabela e Analizës SWOT në fushën e Shëndetësisë**

| Sukseset | Mundësitë |
|---|---|
| • Vizita dhe shërbime të qasshme dhe gjithë përfshirëse në objektet shëndetësore që frekuentohet nga pjesëtarët e komuniteteve për vetëdijësimin për shërbimet shëndetësore<br>• Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shëndetin publik përmes ligjëratave, shpërndarjes së broshurave dhe mënyrave të tjera të informimit<br>• Qasje e lehtë në shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor<br>• Shërbime shëndetësore për fëmijë deri në 18 vjeç pa pagesë | • Fushata vetëdijësuese për planifikimin familjar<br>• Lirimi nga pagesa për familjet në nevojë<br>• Sigurimi i barnave esenciale<br>• Organizimi i fushatave vetëdijësuese për përmirësimin e edukimit shëndetësor<br>• Organizimi i kontrollave periodike për femra (rastet e kancerit të gjirit)<br>• Bashkëpunimi me OJQ-ët vendore dhe ndërkombëtare që ofrojnë shërbime në fushën e shëndetësisë |

| | |
|---|---|
| • Ofrimi i shërbimeve shëndetësore falas për rastet sociale<br>• Ofrimi i shërbimeve shëndetësore falas për shtatzënat dhe vizitat në shtëpi<br>• Shërbime falas për rastet e sëmundjeve kronike dhe pensionistët<br>• Ofrimi i shërbimeve të kujdesit paliativ në shtëpi | |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |
| • Kequshqyerja<br>• Mos furnizimi i rregullt i barnave nga lista esenciale<br>• Mungesa e Sish (Sistemi i Informimit Shëndetësor) për të siguruar informata të sakta për gjendjen shëndetësore<br>• Mos përfshirja në tersi e vaksinimit të fëmijëve nga këto komunitetet<br>• Edukimi i pamjaftueshëm shëndetësor<br>• Niveli i ulët i të hyrave për familjet me asistencë sociale | • Përhapja e sëmundjeve ngjitëse dhe epidemive<br>• Vdekjet e hershme<br>• Planifikimi jo-i mirë familjar<br>• Mos vazhdimi i kontrolleve dhe marrjes së terapive sipas udhëzimeve të personelit mjekësor<br>• Mos respektimi i akteve ligjore në fushën e shëndetësisë |

## 2.4. Banimi

Gjendja në Komunën e Fushë Kosovës për sa i përket çështjes së banimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në mënyrë të vazhdueshme është përmirësuar. Megjithatë, një numër i familjeve kanë probleme me kushte të vështira të banimit, kanë mungesë të pronave për ndërtim të shtëpive, kanë probleme me dokumentacion të pronës.

Është me rëndësi të përmendet se në vitet e fundit është progres në sigurimin e banimit të qëndrueshëm edhe për familjet e ri-athtësuara.

Analiza SWOT ka nxjerr edhe disa të dhëna të tjera që janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

**Tabela e Analizës SWOT në fushën e Banimit**

| Sukseset | Mundësitë |
|---|---|
| • Ndihma emergjente e disa familjarëve për banim në bashkëpunim me ministrin e linjës<br>• Pagesa e qirasë për familjet e komuniteteve që nuk kanë të zgjedhur çështjen e banimit<br>• Rregullimi i infrastrukturës përcjellëse në lagjet ku jetojnë komunitetet | • Ndërtimi i shtëpive të reja nga Komuna dhe nga Ministrit përkatëse<br>• Ndërtimi i shtëpive të reja me ndihmën e donatorëve<br>• Renovimi i shtëpive ekzistuese nga komuna , ministrit dhe donatorët<br>• Ristrukturimi i vendbanimeve të komuniteteve për një jetë ma cilësore<br>• Zbatimi i legjislacionit sa i përket lehtësirave tek rregullimi i pronësisë |
| **Dobësitë** | **Reziqet** |
| • Numër i madh i kërkesave të familjeve të cilat nuk kanë të zgjedhur çështjen e banimit<br>• Numër i madh i familjeve të cilët nuk e kanë rregulluar çështjen e pronësisë | • Imigrimi i madh i banorëve nga komunat tjera, brenda Komunës së Fushë Kosovës dhe nga procesi i riatdhesimit<br>• Mungesa e Legjislacionit për ndërtim dhe renovim të shtëpive në pronat private |

| | |
|---|---|
| • Mungesa e aprovimit të Ligjit për banim të qëndrueshëm dhe të përballueshëm<br>• Mungesa e pronës komunale për ndërtimin e objekteve kolektive për banim social | • **Krijimi i lagjeve joformale** |

## 2.5. Diskriminimi

Diskriminimi në përgjithësi në Kosovë mbetet një problem që ndikon në fusha të ndryshme të jetës sociale, ekonomike dhe politike.

Edhe pse ka përparim në aspektin ligjor dhe institucional, diskriminimi vazhdon të jetë i pranishëm në forma të hapura dhe të fshehura, sidomos në aspektin gjinor, por tek komuniteti rom dhe ashkali është më shumë prezent për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

**Në institucionin e Komunës së Fushë Kosovës nuk është evidentuar ndonjë formë e diskriminimit të qëllimshëm.**
**Të gjitha politikat dhe praktikat zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët pa dallim gjinie moshe, etnie apo përkatësie tjetër.**
Në fushën e Arsimit të gjithë nxënësit e komuniteteve janë të përfshirë në sistemin Arsimor (Por ende është sfidë braktisja, martesat e hershme dhe gjendja e rëndë ekonomike e familjeve të komuniteteve rom , ashkali dhe egjiptian) , ndërsa rastet e problemeve individuale të raportuara janë trajtuar në mënyrën më të mirë të mundshme nga shkollat dhe Drejtoria e Arsimit të Komunës.
Te fusha e shëndetësisë për të gjithë qytetarët pa dallim ofrohen shërbime shëndetësore të qasshme dhe të domosdoshme, skema sociale të gjitha grupet e komunitetit rom , ashkali dhe egjiptas janë të
barabartë për të përfituar përkrahjen e ndihmës sociale në përputhje me ligjin e fushës përkatëse, po ashtu ky komunitet ka të drejtë t'iu drejtohet institucionit të QPS për ofrimin e shërbimeve Sociale dhe familjare në çdo kohë, sa i përket fushës së banimit Komuna e Fushë Kosovës ka punuar në ngritjen e cilësisë së banimit duke bërë ndërtimin dhe renovimin e shtëpive të këtyre komuniteteve, por si sfidë mbetet familjet të cilat nuk kanë pronë dhe familjet të cilat nuk e kanë të rregulluar çështjen e pronësisë dhe në këto raste nuk

mund të ju ndihmohet në çështjen e banimit për familjet që kanë nevojë, si sfidë tjetër na paraqet edhe migrimi i tyre komuniteteve (shitja e shtëpive pronave ) dhe pastaj edhe riatdhesimi i tyre .
Sa i përket punësimit në sektorin publik, në kushtet e barabarta obligohen institucionet komunale që t'i përmbushin obligimet ligjore. Drejtoria e Arsimit ka të punësuar dy Mësimdhënëse nga radhët e këtyre komuniteteve po ashtu ka të punësuar edhe staf teknik në shkolla ,ndërsa në Shëndetësi kemi të punësuar një zyrtar në Qendrën për Punë Sociale, sa i përket punësimit në sektorin privat institucionet komunale duhet të gjejnë format e bashkëpunimit për stimulimin e punësimit të komuniteteve e që është në interes edhe të bizneseve dhe të punësuarve.

**Tabela e Analizës SWOT në fushën e Diskriminimit**

| **Sukseset** | **Mundësitë** |
| --- | --- |
| • Zbatimi i barabartë i politikave publike për të gjithë qytetarët e Komunës së Fushë Kosovës<br>• Promovimi i tolerancës dhe edukimit qytetar në shkolla, shërbime shëndetësore , shërbimet sociale , shërbime publike etj..;<br>• Rritja e llogaridhënies dhe ndëshkimit ndaj ushtruesve të diskriminimit;<br><br>- Shtrirja dhe qasja e lehtë në shërbime publike<br>- Trajnimet e stafit profesional në respektimin e Ligjit për të drejtat dhe lirit e njeriut, Ligjet për parandalimin e diskriminimit dhe ligjet tjera përkatëse të kësaj fushe . | • Trajnime të vazhdueshme profesionale për zyrtarë publikë kundër diskriminimit, ngritja e kapaciteteve profesionale .<br>• Fuqizimi i mekanizmave të avancimit dhe barazisë<br>• Thellimi i bashkëpunimit me organizatat që promovojnë mos diskriminimin.<br>• Parandalimi dhe zvogëlimi i rasteve të personave të pa regjistruar |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |

| | |
|---|---|
| • Mungesa e raporteve të rregullta për perceptimin e qytetarëve<br>• Vetëdijesimi jo i duhur i popullatës për fenomenin e diskriminimit | • Ndjeshmëria jo e mirë e rasteve të ndryshme<br>• Gjendja e rëndë ekonomike dhe papunësia<br>- Mos besueshmëria ndaj institucioneve<br>• Mos regjistrimi i lindjeve të reja |

# 3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Siç është paraqitur në analizën e gjendjes, ky plan i veprimit do t'i ketë 5 fusha kryesore të bazuara edhe në Strategjinë për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës.
Për secilën nga këto fusha është përcaktuar një objektivë strategjike, ndërsa për çdo objektivë janë përcaktuar rezultatet të cilat do të arrihen duke i zbatuar aktivitetet specifike.
Më poshtë do të paraqiten objektivat strategjike, rezultatet dhe aktivitetet për secilën fushëveprim të Planit të Veprimit.

## 3.1. Arsimi

Ky Plan i Veprimit parasheh disa aktivitete që do të avancojnë Arsimin për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

**Objektiva strategjike 1**

Për të siguruar avancimin dhe rezultate të mira në fushën e Arsimit është përcaktuar ky objektiv strategjik:

**Objektivi 1: Rritja e efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**

### 3.1.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e arsimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 1.1.** Përmirësohet pjesëmarrja në Arsimin parafillor të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- **Rezultati 1.2.** Përmirësohet pjesëmarrja në Arsim fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- **Rezultati 1.3.** Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

### 3.1.2. Përshkrimi i aktiviteteve

| REZULTATI 1.1: | Përmirësohet pjesëmarrja në Arsimin parafillor të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian |
|---|---|
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 1.1.1**<br>Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin para fillor | DKA-në dhe shkollat ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, për çdo fillim vit shkollor organizon fushatë vetëdijësuese për regjistrim në edukimin parafillor të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.<br>Fushata vetëdijësuese përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat. |

| | |
|---|---|
| | |
| **REZULTATI 1.2:** | **Përmirësohet pjesëmarrja dhe të zvogëlohet braktisja në Arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian** |
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 1.2.1**<br>Organizimi i fushatave vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë | ZKKK në bashkëpunim me DKA-në, shkollat dhe EPRMB-et ku frekuentojnë nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, për çdo fillim vit shkollor organizon fushatë vetëdijësuese për regjistrim në edukimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.<br>Fushata vetëdijësuese përfshin organizimin e takimeve individuale me familjet e komuniteteve; shpërndarje të informatave për regjistrim. Fushatat organizohen nga shkollat, derisa ZKKK dhe DKA ofrojnë përkrahje për shkollat. |
| **Aktiviteti 1.2.2**<br>Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe | ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e familjeve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së Arsimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me pako shkollore së paku një herë në vit. |

| | |
|---|---|
| sigurimi i mjeteve Arsimore | Përveç përkrahjes me pako shkollore nga vet komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojnë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënës me pako shkollore apo edhe me veshmbathje. |
| **Aktiviteti 1.2.3**<br>Adresohen rastet e braktisjes dhe fëmijëve të ri-athtësuar | DKA dhe ZKKK në bashkëpunim në nivel komune, identifikon të gjithë fëmijët që kanë braktisur shkollimin dhe familjet e ri-athtësuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerr të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve.<br>Në rastet e braktisjes, ZKKK dhe DKA aktivizojnë të gjithë mekanizmat për të siguruar vijimin e shkollimit nga nxënësit braktisësh.<br>Për rastet e fëmijëve të ri-athtësuar, ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të riatdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore p.sh. përkrahje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrahje për të notifikuar dokumentet. |
| **REZULTATI 1.3:** | **Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian** |
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 1.3.1.**<br>Organizohet mësimi plotësues dhe shtesë për fëmijët e | DKA në bashkëpunim me OJQ-të, organizojnë mësim plotësues dhe shtesë për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kanë rezultate të ulëta të nxënit. Bartës kryesor për organizmin e mësimit shtesë mund të jenë OJQ-të, derisa DKA, shkollat dhe ZKKK ofrojnë mbështetje organizative dhe në mobilizimin e donatorëve. |

| | |
|---|---|
| komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian | |
| **Aktiviteti 1.3.2.** Organizohet arsimimi jo-formal për fëmijët që kanë vonesa në shkollimin e obliguar | DKA, ZKKK dhe shkollat në bashkëpunim MASHT dhe OJQ-të do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkollimin e obliguar. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe në trendin e kthimit / riatdhesimit të familjeve nga vendet e ndryshme, sa do që të jetë një numër i konsideruar i fëmijëve që do të kenë nevojë të përfshihen në këtë aktivitet.<br><br>Arsimi jo-formal do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij Plani të Veprimit me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve. Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë për rastet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e rregullt shkollor. |
| **Aktiviteti 1.3.3.** Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjykimeve për mësimdhënës ndaj nxënësve | DKA në bashkëpunim me donatorët dhe me OSHC-të që ofrojnë trajnime të kësaj natyre, organizojnë trajnime periodike kundër diskriminimit dhe paragjykimeve për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali.<br><br>Trajnimet e tilla do t'i përgatisin mësimdhënësit që të krijojnë një ambient miqësor dhe përkrahës për të gjithë fëmijët në klasë, pa kurrfarë dallime. Po ashtu, këto trajnime do të ndihmojnë mësimdhënësit që të krijojnë klasa gjithëpërfshirëse, duke përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve në klasë. |
| **Aktiviteti 1.3.4.** Monitorimi i suksesit dhe | DKA në bashkëpunim me ZKKK dhe me shkollat monitorojnë suksesin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët janë përfitues të skemave të ndryshme përkrahëse (përfituesit |

| | |
|---|---|
| qëndrueshmëria e intervenimit | e subvencioneve , përfituesit e pakove shkollore, përfituesit e mësimit intensiv). Në baza vjetore hartohet një raport i cili shpërndahen tek sektorët përgjegjës |

### 3.1.3. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 1 të paraparë me këtë dokument janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për rritjen e nivelit të përfshirjes, zvogëlimin e rasteve të braktisjeve të shkollimit dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin para universitar, duke i realizuar aktivitetet e parapara me këtë dokument;
- MASHT tregon përkushtim për përfshirjen në mësim intensiv të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kanë vonesa në shkollimin e obliguar
- Mësimdhënësit e trajnuar do të zbatojnë metoda dhe teknika në procesin mësimor për të siguruar një ambient mik për të gjithë fëmijët, pa dallime

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 1 të paraparë me këtë dokument janë:

- Mosgatishmëria e shkollave për të zbatuar politikat për arsimin jo formal pasi mundësit për pranimin e mësimdhënësve shtesë është e vogël
- Mungesa e buxhetit nga MASHT për përkrahje të mësimit intensiv
- Mosgatishmëria e një pjese të prindërve të komunitetit për të bashkëpunuar me institucionet për të adresuar problemet e përfshirjes në Arsim

## 3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Gjatë punës për hartimin e këtij Plani të Veprimit është konstatuar se përmirësimet në këtë fushë do të kenë ndikim shumë të madh në përmirësimin e mirëqenies sociale, do të motivoj të rinjtë që t'i kushtojnë më shumë rëndësi shkollimit, rrjedhimisht shumë probleme të identifikuara në kuadër të këtij Plani do të adresoheshin apo zgjidheshin.
Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, punësimi dhe mirëqenia sociale është përmbledhur në një objektiv strategjik të Planit, që parasheh ndërmarrjen e disa veprimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes ekonomike-sociale të komuniteteve rom dhe ashkali.

**Objektiva strategjike 2**

Në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale është përcaktuar ky objektiv strategjik:

**Objektivi 2: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**

### 3.2.1. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale parashihet arritja e rezultateve të pritshme si në vijim:

- **Rezultati 2.1.** Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemimit të punësimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimit profesional;
- **Rezultati 2.2.** Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes sensibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe masave stimuluese për punëdhënës;
- **Rezultati 2.**3. Përfshirja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në punësim në institucione publike lokale, sipas ligjeve në fuqi.

### 3.2.2. Përshkrimi i aktiviteteve

| REZULTATI 2.1: | Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemit të punësimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimit profesional |
|---|---|
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 2.1.1** Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe ofrimi i këshillave për punësim | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (i të papunëve dhe punëkërkuesve) dhe harton një data bazë. Në bazë të nevojës harton plane përkrahëse këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme me qëllim të rritjes së punësimit të përfaqësuesve të komuniteteve. |
| **Aktiviteti 2.1.2** Ofrimi i trajnimeve profesionale nga QAP për punëkërkuesit | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit dhe në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëkërkuesve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, harton plane për përfshirjen në trajnime varësisht nga kërkesa për aftësim profesional.<br><br>Organizimi i trajnimeve mund të bëhet duke i përfshirë përfituesit potencial në programe të ndryshme që janë duke u zbatuar nga donatorët dhe institucionet . |
| **Aktiviteti 2.1.3** | ZKKK në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, Zyrën për Punësim dhe Mekanizimit kundër dhunës në familje bashkëpunojnë |

| | |
|---|---|
| Monitorimi i rasteve të dhunës në familje | në mundësit të zgjedhjes së problemit të punësimit dhe ri integrimit të këtyre rasteve . |
| **Aktiviteti 2.1.4**<br>Identifikimi i familjeve që janë në asistencë sociale, dhe familjeve të cenueshme, ofrimi i ndihmave me pako ushqimore, veshë mbathje dhe higjienike | ZKKK në bashkëpunim me QPS-të do të bëjë identifikimin e familjeve me asistencë sociale, ZKKK do të shpërndajë pako me material ushqimorë, veshmbathje dhe higjienik për këto familje. |
| **REZULTATI 2.2:** | **Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes sensibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe masave stimuluese për punëdhënës** |
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
